

VENDIM
Nr. 262, datë 29.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 661, DATË 8.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, “SKELE-UJI I FTOHTË, BASHKIA VLORE”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tabelën e dytë, me titullin “Zona II, Shkolla e Marinës–Uji i Ftohtë”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 661, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, numri rendor 4 (katër) bëhet sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlera shtesë prej 10 297 105.40 (dhjetë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesë pikë dyzet) lekësh e kësaj pasurie do të përballohet nga “Fondi i shpronësimeve”, në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “SKELE-UJI I FTOHTË”

(“ZONA II, SHKOLLA E MARINËS-UJI I FTOHTË”)

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e prekur (truallit) (m ²)	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit, lekë	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera lekë e truallit	Vlera e ndërtesës lekë	Vlera totale truall	Shënime
4	Alije Selmanaj Bashkime Duka Hiqmet Mici Kenaqesi Gjini Rahim Mici Violeta Mici	8602	77/5	1012.10	0	10,174	60,607	10,297,105.40	0	10,297,105.40	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, lloji “truall”

